



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

DREJTORIA PËR BUJQËSI
UPRAVA ZA POLJOPRIVREDU
DEPARTMENT OF AGRICULTURE

Adresa: Dëshmorët e Kombit

DATA/DATUM/DATE	22.10.2025
11 NR/BR.	Zyrtare
PËR/ZA/TO	Tabelën e shpalljeve
NGA/OD/FROM	z. Burim Bajrami Drejtore i Drejtorisë për Bujqësi
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Thirrje për aplikim



Thirrje për aplikim

Drejtoria për Bujqësi e Komunës së Ferizajt në përkrahje të zhvillimit të bujqësisë për vitin 2025 shpallë Thirrjen për aplikim për projektin : **Furnizimi i fermerëve prodhues të fidaneve të perimeve me pajisje për mbjelljen e farave të perimeve ose luleve**

Përfitues do të jenë fermerët që i plotësojnë këto kritere:

- Të jetë banor i komunës së Ferizajt,
- Pronën ta ketë në komunën e Ferizajt,
- Të jetë kultivues i rregullt i fidanëve të perimeve ose luleve

Përparësi kanë :

- Fermerët që kanë aplikuar për subvencione- pagesa direkte në MBPZHR për vitin 2025,
- Fermerët që kanë përvojë më të gjatë në kultivimin fidaneve të perimeve ose luleve.
- Në kushte të barabarta përfitojnë fermerët që kanë aplikuar më herët.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit,
- Fletëaplikacionin e plotësuar (mirret në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve),
- Dëshminë kadastrale për pronësi (fletën poseduese) origjinal (jo më të vjetër se 6 muaj),
- Dëshmitë për shitjen e produkteve nga ferma e juaj nëse keni.
- Dëshminë e aplikimit për subvencione për vitin 2025

Fermerët e interesuar do të aplikojnë në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve- kati përdhësë- Komuna Ferizaj.

Afati për aplikim fillon nga data 22.10.2025 deri më 31.10.2025